



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M  
(projekt)

(Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2022)

PËR  
"KRITERET PËR NDARJEN E SHKELJEVE ME PASOJA TË LEHTA APO ME  
PASOJA TË RËNDA DHE SANKSIONET FINANCIARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 36, pika 10, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Shkeljet në Fondin Pyjor Kombëtar vlerësohen me pasoja të rënda, në varësi të dëmit mjedisor që shkaktojnë dhe pasojave që sjellin në pyje, mbështetur mbi kriteret e mëposhtme:
  - a) kur janë kryer në një zonë pyjore të mbrojtur mjedisore, sidomos në zonat që janë me status strikt të mbrojtur dhe parqeve kombëtare, duke i nxjerrë ato jashtë funksionit, për të cilin kanë marrë statusin aktual të mbrojtjes;
  - b) kur kanë shkatërruar një monument natyror, të shpallur si të tillë;
  - c) kur janë kryer në ngastrat e përfshira në, rezervat strategjike, pyjet e virgjër, eksperimentale e studimore, kanë dëmtuar grumbujt e drurëve dhe të llojeve pyjore, të paracaktuara për konservim, germoplazmë, "in-situ" dhe "ex-situ", për grumbullim, përpunim, shpërndarje dhe certifikim të materialit mbjellës;
  - d) kur janë kryer në një pyll mbrojtës, të cilësuar të tillë në planet e mbarështimit, duke e nxjerrë atë jashtë funksionit, për të cilin kanë marrë statusin aktual mbrojtës;
  - e) kur kanë dëmtuar në masë dhe asgjësuar, me prerje, me shkulje, me marrje, individë të llojeve të florës, të rralla, të rrezikuara e që gëzojnë status të veçantë mbrojtjeje dhe ka shkatërruar cilësitë e një habitati konkret, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi;

- f) kur janë importuar dhe/ose mbjellë fara, fidanë, kalemave apo shpatulla të infektuara e të sëmurë dhe të pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe atë fitosanitare;
  - g) kur kullotja kryhet në pyllëzimet e kryera 10-vjeçarim e fundit dhe në sipërfaqet e ricunguara 5-vjeçarim e fundit;
  - h) kur dëmtohet filizëria në grumbujt pyjorë në masën mbi 30%, të sipërfaqes së nënngastrës pyjore;
  - i) kur dëmtohen elementë të infrastrukturës pyjore;
  - j) kur tjetërsohen sipërfaqe të fondit pyjor në truall në masën mbi 0.1 ha, në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi;
  - k) kur kryhen prerje shfrytëzuese në kufirin e sipërm të vegjetacionit, në masën mbi 0.1 ha;
  - l) kur në një grumbull pyjor kryhen prerje të paligjshme në masë, në një sipërfaqe mbi 0.5 ha;
  - m) kur falsifikohet dhe përdoret çekiçdamka dhe kur markohet materiali drusor, pa lejen e strukturave përkatëse;
  - n) kur zjarrvënia dhe djegia e sipërfaqeve pyjore, bëhet me dashje dhe me qëllim përfitimi;
  - o) kur kryhet krasitje për gjeth mbi 30% të sipërfaqes së nënngastrës pyjore;
  - p) kur nxirren rrënjë, kucka dhe zhardhokë në masën mbi 30 %, të individëve dhe/apo sipërfaqes së vlerësuar;
  - q) kur nga sipërfaqet pyjore nxjerren gurë, merret dheu apo humusi mbi 30 % të sipërfaqes së vlerësuar, prej 1 ha;
  - r) kur transporti dhe eksporti i lëndës drusore dhe bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore, kryhet pa dokumentat përkatëse të lëshuara nga organet e ngarkuara me ligj (akt-miratimi, kontratë, leje shfrytëzimi, vertetim transporti dhe certifikatë origjinë);
  - s) kur kundravajtjet administrative janë të përsëritura;
  - t) kur nuk realizohen pyllëzimet, si detyrim i subjekteve që zhvillojnë aktivitet në fondin pyjor;
  - u) kur pengohen strukturat qendrore dhe vendore përgjegjëse për pyjet, apo strukturat inspektuese e kontrolluese në kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji.
3. Shkeljet që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, konsiderohen shkelje me pasoja të lehta.
4. Sanksionet financiare përcaktohen rast pas rasti, duke u mbështetur në tarifatat për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor kombëtar dhe të gjobave të përcaktuara në nenin 36, të ligjit 57/2020, "Për pyjet".
- 4.1 Për përcaktimin e sanksioneve financiare së një dëmi konkret të shkaktuar në fondin pyjor kombëtar, mbahen parasysh treguesit si me poshtë:
- a. sipërfaqja pyjore që është dëmtuar (prerë, djegur, zënë, gërryer, krasitur e kullotur), e shprehur në njësinë fizike (ha) duke evidentuar natyrën e dëmtimit të mbulesës pyjore të saj;

- b. shkalla e dëmtimit të sipërfaqes së dëmtuar ndaj totalit të saj të shprehur në %;
  - c. mënyra dhe mjetet konkrete me të cilat është shkaktuar dëmi;
  - d. sasia e drurëve të dëmtur, me vlerën e përlogaritur sipas pikës 4, të këtij vendimi;
  - e. llojet të dëmtuar me status të veçantë/rrezikuar: drurë faror, lloje të kërcënuara ose në rrezik zhdukje, fidane në fidanishte, germoplazmë (fruta, fara) dhe parcela eksperimentale, duke llogaritur dëmin sa trefishi i vlerës sipas pikës 4, të këtij vendimi;
  - f. sanksionet për dëmet e tjera vlerësohen sipas pikës 4, të këtij vendimi;
  - g. shpenzimet që nevojiten për t'a riparuar dëmin.
5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**